



Aleanca

Datë: 15.07.2026

Nr. Fiskal: 600535019

FTESË PËR OFERTË

Për angazhimin e një Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të komunikimit dhe marketingut

Data e publikimit: 15.07.2026

Aleanca fton operatorët ekonomikë të interesuar të paraqesin ofertat e tyre për ofrimin e shërbimeve profesionale në fushën e komunikimit, marrëdhënieve me publikun dhe marketingut digjital.

1. Objekti i kontratës

Operatori Ekonomik do të ofrojë shërbime profesionale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Hartimin dhe zbatimin e strategjisë së komunikimit;
- Këshillim strategjik në komunikim publik dhe politik;
- Menaxhimin e rrjeteve sociale;
- Krijimin e përmbajtjes për rrjetet sociale dhe platformat digjitale;
- Dizajn grafik për materiale promovuese dhe institucionale;
- Incizim, montazh dhe editim të materialeve video;
- Monitorim mediatik dhe përgatitje të raporteve periodike;
- Mirëmbajtje dhe përditësim të ueb-faqes zyrtare të Aleancës;
- Mbështetje në organizimin dhe promovimin e aktiviteteve publike;
- Shërbime të tjera profesionale në fushën e komunikimit dhe marketingut, sipas kërkesave të Aleancës.

2. Kualifikimet minimale

Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë:

- përvojë të dëshmuar në ofrimin e shërbimeve të komunikimit, marketingut, marrëdhënieve me publikun ose fushave të ngjashme;
- staf profesional me përvojë në menaxhimin e komunikimit, dizajnit grafik, prodhimit të videove dhe administrimit të platformave digjitale;
- referenca ose kontrata të mëparshme që dëshmojnë përvojën në realizimin e shërbimeve të ngjashme;
- kapacitet organizativ dhe teknik për ofrimin e shërbimeve të kërkuara.



Aleanca

3. Dokumentet që duhet të dorëzohen

Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë:

- Ofertën financiare;
- Përshkrimin e metodologjisë së punës;
- Profilin e kompanisë;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Certifikatën e Numrit Fiskal;
- Referenca dhe dëshmi për përvojën profesionale;
- CV-të e personelit kyç që do të angazhohet në realizimin e kontratës (nëse aplikohet).

4. Vlerësimi i ofertave

Ofertat do të vlerësohen duke marrë parasysh:

- përvojën profesionale të operatorit ekonomik;
- cilësinë e metodologjisë së propozuar;
- kapacitetet profesionale dhe teknike;
- referencat e realizuara;
- ofertën financiare.

Aleanca rezervon të drejtën të zhvillojë negociata me operatorët ekonomikë të përzgjedhur para marrjes së vendimit përfundimtar dhe nuk obligohet të përzgjedhë domosdoshmërisht ofertën me çmimin më të ulët, por atë që vlerësohet si më e favorshme në aspektin profesional dhe ekonomik.

5. Afati dhe mënyra e dorëzimit të ofertave

Afati për dorëzimin e ofertave është **10 (dhjetë) ditë kalendarike** nga data e publikimit të kësaj ftese.

Data e fundit për dorëzimin e ofertave: 25.07.2026, deri në orën 16:00.

Ofertat mund të dorëzohen në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

- **Fizikisht**, në zyrat e Aleancës, në zarf të mbyllur me mbishkrimin: *"Ofertë për Shërbime të Komunikimit dhe Marketingut – Të mos hapet para vlerësimit"*;
- **Elektronikisht**, në adresën elektronike: lulzimleci@yahoo.com.

Ofertat e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të merren në shqyrtim.



Aleanca

6. Informata shitesë

Aleanca mund të kërkojë sqarime ose dokumentacion shitesë nga operatorët ekonomikë gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.

ALEANCA

Nr. Fiskal: 600535019



Komisioni për Vlerësimin e Ofertave